



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec - Opštine Orahovac  
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë  
Odeljenje za Geodeziju, Katastar i Imovinu

Nr. I prot. 1395 Më Dt. 02.04.2026  
II- Pr. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC



**Komuna e Rahovecit**  
**Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**

Datë/a	03.04.2026
Referencë/a	
Për/Za/To :	Z. Smajl Latifi - Kryetar i Komunës së Rahovecit
CC:	
Përmes/Prekp/Through:	
Nga/Od/From :	Besmire Bytyçi Drejtoreshë e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Raporti tre mujor i punës, janar-mars 2026



**RAPORTI TREMUJOR I PUNËS JANAR-MARS 2026**

Fillimi i vitit 2026, është karakterizuar me angazhim të shtuar në përmbushjen e detyrave të reja, si dhe në përfundimin e obligimeve të bartura nga viti paraprak. Në tre mujorin e parë të vitit 2026, aktivitetet tona janë zhvilluar në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Kryetari i Komunës, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për Vitin 2026.

Gjatë tre mujtorit të parë të vitit 2026, aktivitetet kryesore të drejtorisë përfshijnë:

- Trajtimi i kërkesave nga qytetarët dhe gjeodetët privatë për ndarje dhe bashkim parcelash, regjistrim dhe çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje të pronave, koordinata, modifikime dhe shërbime tjera sipas kërkesave;
- Lëshimin e certifikatave dhe kopjeve të planeve Kadastrale;
- Hartimi i listës së veçantë të pronave komunale;
- Përgatitjen e materialeve për dhënien në shfrytëzim të pronave publike për Kuvendin Komunal, sipas kërkesave të qytetraëve dhe grupeve të interesit;
- Gjeodetët kanë kryer matje sipas kërkesave të drejtorive përkatëse, për rrona komunale të cilat janë në interes të komunës;
- Kemi vlerësuar performancën e punonjësve për vitin paraprak;

- Në projektin e vektorizimit të disa Zonave Kadastrale, jemi në proces e sipër, për 16 ZK ky proces do të përfundojë në muajin Prill 2026;
- Kemi trajtuar lëndët me dyshim për uzurpim të pronës publike, në këtë periudhë janë marrë dy vendime për uzurpim, të dyja këto në ZK Xërxe;
- Dhe, kryerjen e detyrave tjera sipas detyrës zyrtare.

Në kuadër të drejtorisë, operojmë me dy sektore:

- 1- Kadastër dhe Pronë
- 2- Gjeodezi

Në tre mujorin e parë të vitit 2026, janë trajtuar këkresa të shumta dhe lëshuar dokumente të ndryshme sipas kërkesave të palëve:

<b>Emërtimi</b>	<b>Numri i lëndëve</b>
Trashëgimi	99
Kontratë shitblerje	84
Kontratë dhurimi	98
Kontratë këmbimi	4
Kontratë qiramarrje	8
Kontratë ndarje fizike	5
Marrëveshje ndërmjetësimi	103
Aktgjykim	6
Hipoteka	8
Cregjistrimi i hipotekës	13
Historiate	5
Azhurnime	20
Barrë tatimore	5
Bashkim ID	26
Modifikim i ID	17
Ndarje e parcelave	25
Bashkim i parcelave	32
Bashkim dhe ndarje	6
Koordinata	79
Legalizim	3

Vendime për uzurpime	2
Servitut	1
Regj. i pjesës së ndërtesë	1
Certifikata të pronës	366
Kopje të planit	27
Kërkesë për social	46
Kërkesë për vërtetim që nuk posedon pronë	10
Kërkesë për dy certifikata	50
Kërkesë për dy kopje të planit	17
Kërkesë për certifikatë të pronës dhe kopje të planit	4
Modifikimi i attributeve të parcelës	1

Të hyrat në drejtori për muajt janar-mars janë:16,078.00Euro.

Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, mbetet e përkushtuar që puna në interes të qytetarëve, bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi, të jetë prioritet i përditshëm i drejtorisë, marrja e shërbimeve në kohë sa më të shpejtë dhe më lehta nga qytetarët do të vazhdojë të jetë fokus i punës sonë të përditshme .

Besmire Bytyçi

*Drejtoresha e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë*

**Komuna Rahovec**

Mob: +383 (49) 199-099 / Ctx: +381 (0) 3820045311

E-mail adresa: [besmire.bytyqi@rks-gov.net](mailto:besmire.bytyqi@rks-gov.net)